
Funded
by the European Union



EUROPEAN UNION



COUNCIL OF EUROPE
CONSEIL DE L'EUROPE

Implemented
by the Council of Europe

PROJEKTI KUNDER KORRUPSIONIT NË SHQIPËRI (PACA)

MANUAL

**Për Bashkëpunimin Ndërkombëtar në Gjurminin, Identifikimin dhe Kthimin e
Asetëve të Krimin të Rëndë dhe atij Financiar**

**Përgatitur nga Gent Ibrahimi
Këshilltar Afatgjatë**

Për çdo informacion të mëtejshëm mund të kontaktoni:

Seksioni i Krimit Ekonomik
Drejtoria e Shoqërisë së Informacionit dhe Veprimit
kundër Krimit
Drejtoria e Përgjithshme I – Të Drejtat e Njëriut dhe
Shtëti Ligjor
Këshilli i Europes, F-67075 Strasbourg Cedex
Tël: + 33 (0)3 88 41 29 76
Fax: +33 (0) 390 21 56 50
Email: lado.lalovic@coe.int
Web: www.coe.int/economiccrime

Ky dokument është prodhuar me mbështetjen financiare të Bashkimit European. Pikëpamjet e shprehura në të nuk mund të konsiderohen si pasqyrim i pozicionit zyrtar të Bashkimit European ose Këshillit të Europës.

Tabela e lëndës

Hyrje.....	4
1. Gjurrimi / Identifikimi.....	4
2. Sekuestrimi dhe konfiskimi.....	8
3. Konfiskimi pas dënimit me vendim të formës së prerë	10
4. Konfiskimi civil	12
5. Këshilla praktike	13
6. Vështirësitë dhe pengesat që hasen tipikisht në procesin e bashkëpunimit ndërkombëtar për sekuestrimin/konfiskimin e asetëve të krimit.....	15
Aneks 1. Kërkesë tip për Sekuestrim të Asetëve	16

Hyrje

Qëllimi i këtij Manuali është t'i vijë në ndihmë prokurorëve në përdorimin efikas të bashkëpunimit ndërkombëtar me qëllim sekuestrimin dhe konfiskimin e aseteve (*produkt dhe instrumentë*) të krimit të rëndë dhe atij ekonomik që gjenden jashtë kufijve të vendit.

Në kohën e sotme, bashkëpunimi ndërkombëtar në formën e ndihmës juridike të ndërsjellë është i një rëndësie esenciale për zhvillimin e hetimeve të sukseshme. Globalizimi i ekonomisë dhe i këmbimeve tregtare ka pasur si efekt anësor të padëshiruar edhe globalizimin e krimit, sidomos të krimit të rëndë dhe atij ekonomik. Përmirësimi i komunikimit ka sjellë rritjen e tregtisë ndërkombëtare dhe të operacioneve bankare ndërkombëtare. Brenda pak sekondash, shumica të mëdha parash lëvizin lirshëm nëpër botë falë transferimeve elektronike, letër – kredive, ATM-ve, kartave të kreditit e debitit etj.

Nuk është qëllimi i këtij Manuali që të trajtojë në mënyrë shteruese të gjithat format e bashkëpunimit ndërkombëtar që përdoren ose mund të përdoren nga prokuroria shqiptare në bazë të ligjit vendas dhe konventave ndërkombëtare të nënshkruara nga Shqipëria, por vetëm ato forma të bashkëpunimit që kanë si qëllim sekuestrimin/konfiskimin ndërkombëtar të aseteve të krimit (*e sidomos të krimit të rëndë dhe atij ekonomik*).

Autorët e krimeve të rënda dhe atyre financiare në vecanti priren që fitimet nga veprimtaria e tyre kriminale t'i investojnë në vende të tjera. Ndëshkimi penal personal shpesh nuk mund të konsiderohet si parandalues i efektshëm përderisa kriminelët (*ose të afërmit e tyre*) vazhdojnë të gëzojnë të mirat materiale të krimit. Aftësia e sistemit të drejtësisë penale për të vënë dorë mbi asetet e krimit, sidomos përmes bashkëpunimit ndërkombëtar, do të jetë e një rëndësie vendimtare për fatet e kesaj lufte.

Cikli i punës së prokurorëve për kthimin e aseteve të krimit konsiston në 3 faza (*identifikimi, sekuestrimi dhe konfiskimi*) të cilat kanë specifikat e tyre.

1. Gjurmimi / Identifikimi

Gjurmimi / Identifikimi i aseteve të krimit të cilat nuk ndodhen në vendin ku zhvillohet ndjekja penale është ndoshta faza më e vështirë në punën e një prokurori. Zhvillimi me sukses i kësaj faze, përveç aftësive të zakonshme profesionale të prokurorit, kërkon edhe fantazi dhe organizim të mirë. Tipikisht, bashkëpunimi ndërkombëtar në fazën e

gjurmimit/identifikimit të aseteve të krimit kryhet ose nëpërmjet kerkimit në bazat e të dhenave të disponueshme ose nëpërmjet kërkesave jo formale të bashkëpunimit (*ndonëse nuk përjashtohet as bashkëpunimi formal përmes letër prorosive*). Në paragrafet që vijojnë jepen disa nga faktoret kryesore që duhet të mbajë parasysh prokurori në fazën e gjurmimit të aseteve.

Identifiko përfituesin e fundit

Në procesin e gjurmimit / identifikimit të aseteve që burojnë nga vepra të tilla penale si korrupsioni në shkallë të gjerë ose krimi i organizuar, prokurori duhet të mbajë parasysh se vëllimi i madh i aseteve kriminale shpesh dikton krijimin dhe kontrollimin nga ana e krimineleve të shoqërive tregtare. Në këto kushte është esenciale që gjurmimi të identifikojë personat fizike të cilët efektivisht kontrollojnë personin juridik përmes të cilit qarkullohen asetet financiare.

Identifiko pastrimin e parave

Në procesin e gjurmimit të aseteve, prokurori duhet të mbajë parasysh se tipikisht i dyshuari (*ose i dënuari*) ka bërë përpjekje për pastrimin e produkteve të krimit duke i bërë ato të duken si të ardhura të ligjshme ose të paktën për të maskuar origjinën e tyre. Në mënyrë që ta bëjë këtë, pavarësisht nga lloji i veprës penale kryesore, kriminelit ka kaluar përmes 3 fazave klasike të pastrimit të parave që përfshijnë futjen fillestare të fondeve në sistemin financiar, konvertimin e ketyre fondeve në asete të llojeve të tjera dhe së fundi integrimin gjatë të cilit fondet ose asetet përfshihen në ekonominë formale përmes blerjes të pronave të patundshme, investimit në biznese formale përmes blerjes së aksioneve etj.

Përpara se të kërkohet ndihmë ndërkombëtare në rrugë jo formale ose formale, prokurori duhet të ketë në konsideratë këto procese dhe t'i formulojë kërkesat për ndihmë në mënyrë të tillë që të sigurohet informacion dhe prova për të gjitha këto veprime.

Po të kemi parasysh se, siç u tha më sipër, çdo krim ekonomik ose i rëndë përfshin lëvizje ndërkombëtare të aseteve, kërkesa për ndihmë ndërkombëtare është ndoshta mjeti më i rëndësishëm në dorën e prokurorit në procesin e gjurmimit / identifikimit të tyre.

Duke qenë kjo e vërtetë, kërkesa për ndihmë (*formale ose jo*) duhet të shtrojë së paku pyetjet e mëposhtme:

- A ka pasur shitje- blerje pasurish të patundshme ose të sendeve të tjera me vlerë?
- A janë vendosur asetet në një juridiksion *off-shore*?
- A ka lidhje të provuara të subjektit me subjekte të tjera;

- Çfarë provash/indiciesh ekzistojnë për stilin e jetës të të hetuarit?
- A janë bërë transfertat bankare;
- Cilat janë kanalet tipike të komunikimit të të dyshuarit (psh personat me të cilët komunikon më shpesh, faturat telefonike etj)

Të dhëna të tjera me rëndësi për gjurmimin/identifikimin

Në procesin e gjurmimit/identifikimit ndërkombëtar të aseteve ka shumë të ngjarë që të dhëna interesante për procesin e hetimit të burojnë nga situatat dhe proceset e mëposhtme në vendin e huaj:

- një hetim penal në zhvillim e sipër;
- një hetim financiar pas marrjes së vendimit përfundimtar për denimin;
- një raport i aktivitetit të dyshimtë;
- një kerkese për ndihmë juridike të ndërsjelltë nga një shtet i tretë;
- dëshmi nga persona të ndryshëm;
- materiale të siguruar nga interceptimet e komunikimeve;
- profili financiar i subjekteve (*te dhënat e tyre bankare, pasuritë e paluajtshme dhe faturat e ndryshme*) etj.

Hapat për t'u ndjekur në një procedurë gjurmimi/identifikimi ndërkombëtar të aseteve

Ndonëse nuk mund të ekzistojë një listë shteruese e veprimeve që mund të ndërmerren nga prokurori në përpjekje e sipër për të gjurmuar / identifikuar asetet që gjendet jashtë vendit (*çdo rast i vecantë paraqet specifika dhe nevoja të ndryshme*), teknikat e mëposhtme janë në përgjithësi të vlefshme:

- kontrole të historisë penale të personave fizike;
- kontrole mbi të dhënat e personave juridikë ku personi i hetuar ka interesa;
- marrje dëshmish;
- të dhëna bankare/financiare;
- të dhëna mbi komunikimet telefonike dhe faturat;
- të dhëna ndihmëse mbi stilin e jetesës, ritmin e shpenzimeve, udhëtimet etj;
- të dhëna nga bazat qeveritare të të dhënave si psh. hyrje daljet kufitare, licenca të akorduara etj;
- të dhëna mbi pasuritë e paluajtshme;
- zbatimimi i teknikave të posaçme hetimore;

Natyrisht që në kontekstin e hetimit ndërkombëtar, teknikat e mësipërme do të mund të zbatohen ose përmes kërkesave jo formale për ndihmë administrative ose përmes letër porosive zyrtare. Se cila prej rrugëve do të përdoret mbetet në gjykimin diskrecional të prokurorit dhe varet nga një sërë rrethanash të tilla si:

- natyra e kërkesës,
- fakti nëse të dhënat kërkohen për indicie ose për t'u përdorur si provë në procesin gjyqësor,
- nëse është i nevojshëm ose jo ushtrimi i forcës shtërnguese nga ana e shtetit të cilit i kërkohet kryerja e veprimeve,
- nëse veprimet e kërkuara kanë nevojë për autorizim gjyqësor në vendin ku bëhet hetimi; si dhe nga
- parimet e përgjithshme të ndihmës juridike të ndërsjellë.

Secila nga teknikat dhe qasjet e rreshtuara me lart mund të jenë në gjendje të sigurojnë prova të natyrave dhe peshave të ndryshme provuese. Zakonisht nuk mund të bëhet një ndarje midis provave që për nga natyra janë më të përshtatshme për të provuar veprën penale bazë dhe atyre që janë më të përshtatshme për të identifikuar asetet e krimit. E vërteta është se secila prej provave mund të përdoret për të dyja qëllimet. Më konkretisht hetimi me teknikat e mesipërme mund ta ndihmojë identifikimin e aseteve duke siguruar të dhëna si më poshtë:

- prova rrethore;
- dëshmi nga bashkëpunëtorët;
- rrëfime nga të dyshuarit;
- dokumenta financiare dhe raporte të auditeve të ndryshme;
- raporte ekspertësh;
- të dhëna për asete me origjinë të dyshimtë;
- transaksione jo të zakonshme biznesi (psh transaksione me humbje);
- struktura jo të zakonshme subjektesh tregtare;
- prova për përfshirjen e ekspertëve ekspertiza e të cilave është e dyshimtë;
- prova për karakteristika të personalitetit të subjektit (psh. i dhunshëm);
- të dhëna që rezultojnë nga lëvizjet dhe shoqërizimet e pikasura nga përgjimet ambientale;
- identitete të rrema, adresa dhe dokumenta

Përdorimi i ekspertizës financiare

Kurdoherë që prokurori gjykon se është e nevojshme që për gjurmimin/identifikimin e aseteve (ose për çdo hetim financiar në përgjithësi) në një vend të huaj është e nevojshme të bëhet një kërkesë, është e këshillueshme që prokurori të konsultohet me një kontabilist ose ekspert kontabël në formulimin e natyrës dhe gjerësisë së kërkesës.

Konsulenca nga kontabilistët dhe ekspertët kontabël luan një rol të rëndësishëm në hetimet financiare në përgjithësi dhe për pasojë përdorimi i saj edhe në hetimet ndërkufitare që kanë për qëllim konfiskimin e aseteve të krimit nuk duhet të neglizhohet.

Kontabilistit apo ekspërtit kontabel mund t'i kërkojen shërbimet e mëposhtme:

- të bëjnë lidhjen mes transaksionëve dhe parave/asetëve të fituara ose të humbura;
- t'i shpjegojnë prokurorit dinamikën e transaksionëve;
- të analizojnë rrjedhën ndërkombëtare të pagesave;
- të ndihmojnë prokurorin të kuptojë menyrën sesi funksionon sektori (*psh sektori bankar, i sigurimeve, sektori i ndërtimit etj.*);
- të identifikojë të ardhura të pajustificuara;
- të bëjë lidhjen midis transaksioneve dhe personave;
- të identifikojë të dhëna të rreme në raportet e auditit;
- të shpjegojë standartet e kontabilitetit;
- të analizojë hyrje daljet e një biznesi.

Këto dije janë të një rëndësie esenciale dhe e mundësojnë prokurorin që të formulojë një kërkesë për ndihmë juridike të arsyeshme dhe të aftë për të vjelur atë informacion që është relevant për identifikimin e aseteve (*dhe eventualisht konfiskimin e tyre*).

2. Sekuestrimi dhe konfiskimi

Ndërsa në rastin e ndihmës për gjurmimin / identifikimin ndërkombëtar të aseteve ndihma e autoriteve të huaja mund të kërkojë në rrugë administrative (*jo formale*) ose formalisht përmes letër porosive (*sigurimi i materialeve që nevojiten në procesin e gjurmimit, në një moment të caktuar do të kërkojë një letër porosi*), kërkesat për sekuestrimin ose konfiskimin e aseteve, duke qenë se kërkojnë ushtrimin e forcës shtrënguese nga shteti të cilit i dërgohet kërkesa, do të bëhen gjithnjë përmes letër porosive.

Të njëjtat parime që udhëheqin ndihmën e ndërsjelltë juridike në përgjithësi vlejnë edhe kërkesat që kërkojnë bashkëpunimin e një shteti tjetër për sekuestrimin/konfiskimin e aseteve. Disa çështje themelore që duhen mbajtur parasysh nga prokurori në këtë fazë të hetimit janë:

- formulimi i letër kërkesës duhet të jetë preçiz;
- kur kërkojë gjurmimi / identifikimi i likuiditeteve është e rëndësishme që kërkesa të mos kufizohet vetëm në emrin e personit që zotëron të drejtën e firmës në llogaritë bankare por të përfshijë edhe përfituesin e fundit dhe çdo prokurë të lëshuar në emër të të tretëve;

- një ndër qëllimet kryesore që duhet të ndjekë prokurori në një procedure për gjurmimin/identifikimin ndërkombëtar të aseteve është që të identifikohet personi fizik që është përfituesi i fundit (*the beneficial owner*);
- kur kërkohet informacion në lidhje me një llogari bankare, letër porosia duhet ta shpjegojë qartë se çfarë kërkon: psh. të specifikojë nëse kërkohet një profil i përgjithshëm i klientit, nëse kërkohen shenimet që menaxhimi i bankës ka bërë në vazhdimësi në lidhje me klientin, nëse kërkohen raportet që personeli i bankës ka hartuar në kuadrin e vigjilencës së duhur në kontekstin e regjimit të parandalimit të pastrimit të parave, nëse kërkohen të dhëna mbi transaksionet bankare etj. Kjo është me të vertetë shumë e rëndësishme sepse rregulla dhe procedura të ndryshme mund të jenë në fuqi në shtetin ku kërkohet të merret informacioni në lidhje me secilën nga këto kategori të dhënash.
- Duke pasur parasysh që institucionet financiare disponojnë të dhëna voluminoze në lidhje me transaksionet bankare të subjektit që hetohet, në mënyrë që të evitohen vonesat e panevojshme, është e udhës që kërkesa për informacion të kufizohet vetëm për disa transaksione me disa karakteristika (*psh mbi një shumë të caktuar*) ose të kufizohet në një periudhë të caktuar kohore.
- Kur kërkohet sekuestrimi i një aseti apo llogarie bankare, duhet mbajtur parasysh se shteti të cilit i dërgohet kërkesa do bëjë ç'është e mundur që të evitojë paditë e mundshme gjyqësore kundër atij vetë nga personat e prekur. Prandaj, kur është e mundur, prokurori merr në konsideratë pasojat mbi të tretët dhe si mund të minimizohen ato (*psh kur kërkohet sekuestrimi i një llogarie të një subjekti juridik*).
- Disa shtete do të pranojnë kërkesat për sekuestrimin vetëm nëq ka filluar një procedim penal në ngarkim të personit pasuria e të cilit kërkohet të sekuestrohet. Këtu është vendi për të bërë një verifikim të rëndësishëm. Në disa vende (*tipikisht vendet me sistemin common law*) procedimi penal do të konsiderohet i filluar vetëm kur personi është marre i pandehur. Në disa vende të tjera, procedimi do të quhet i filluar thjesht kur është regjistruar një çështje penale. Se fundmi duhet verifikuar se shteti të cilit do t'i dërgohet kërkesa nuk i përket atij grupi shtetesh të cilët pranojnë të japin asistencë vetëm kur ka një vendim penal të formës së prerë;
- Në rastet kur, pas vendosjes së masës së konfiskimit, bëhet një kërkesë për kthimin e aseteve, prokurorët duhet të mbajnë parasysh se kujt do t'i kthehen asetet. Për shembull disa shtete njohin të drejtën e viktimave të korrupsionit ose të krimit ekonomik në përgjithësi për të kërkuar dëmshpërblim. Definicioni i viktimës ndryshon nga një juridiksion në tjetrin. Është esenciale që të zhvillohen konsultime midis shteteve të përfshira sidomos në ato raste kur shteti të cilit i

drejtohet kërkesa kërkon të informohet se kujt do t'i kthehen asetet. Problematike është situata kur asetet e vjedhura janë shtetërore dhe janë vjedhur nga një politikan.

Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit UNCAC, përbën kuadrin ndërkombëtar bazë për sekuestrimin dhe konfiskimin e asetëve të përfituara si rezultat i mitmarrjes, vjedhjes së fondeve publike dhe shpërdorimit të detyrës. Prandaj është e këshillueshme që kjo konventë të citohet sa herë që bëhen kërkesa për konfiskimin e asetëve të derivuara nga këto krime. UNCAC fokusohet në bashkëpunimin ndërkombëtar për konfiskimin e asetëve dhe parashikon një sërë mekanizmesh penalë dhe civilë për sekuestrimin dhe konfiskimin e asetëve të korrupsionit si më poshtë:

- urdhëra konfiskimi pas dënimit me vendim penal të formës së prerë;
- urdhëra konfiskimi *in rem* ;
- urdhëra për sekuestrimin e asetëve për nevojat e hetimit dhe procedimit penal në një vend tjetër;
- zbatimi në vendet nënshkruese i urdhërave të institucioneve të huaja për konfiskim civil ose penal të asetëve;
- vendime të ndërmjetme që sekuestrojnë asetet në pritje të përfundimit të procedimit.

Ndërsa përsa i takon krimeve të rënda, kuadri ndërkombëtar bazë për sekuestrimin dhe konfiskimin e asetëve përbëhet nga Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Krimin të Organizuar Ndërkufitar. Kjo konventë duhet të citohet sa here që bëhen kërkesa për konfiskimin e asetëve të derivuara nga këto krime. UNTOC fokusohet në bashkëpunimin ndërkombëtar për konfiskimin e asetëve dhe parashikon një sërë mekanizmesh penalë dhe civilë për sekuestrimin dhe konfiskimin e asetëve të korrupsionit si më poshtë:

- urdhëra konfiskimi pas dënimit penal të formës së prerë;
- kërkesa paraprake për identifikimin dhe sekuestrimin e asetëve.

3. Konfiskimi pas dënimit me vendim të formës së prerë

Kthimi i asetëve të krimin pas dënimit përfundimtar të kriminelit nëpërmjet një urdhëri konfiskimi është një kusht i domosdoshëm për të goditur me efikasitet dhe parandaluar krimet me natyrë ekonomike (*korrupsioni, krimi financiar dhe krimi i organizuar*). Mënyra e vetme për ta shtrirë veprimin e këtij sistemi jashtë kufijve është bërja e kërkesave për ndihmë juridike të ndërsjellë.

Verifikimi i parë që duhet të bëjë prokurori përpara se të fillojë një procedurë për

kthimin e aseteve të krimit është nëse shteti ku mendon ta çojë kërkesën është apo jo nënshkrues i UNCAC apo i UNTOC. Në qoftë se po, shteti jo vetëm që është i supozuar të ketë një sistem efikas të konfiskimit të pasurive të krimit por është edhe i angazhuar për bashkëpunim ndërkombëtar në këtë drejtim.

Shtetet që aderojnë në këto konventa janë të supozuara të kërkojnë nga shtetet e tjera gjurmimin, identifikimin, sekuestrimin dhe konfiskimin e aseteve si dhe të zbatojnë për llogari të këtyre të fundit këto masa.

Është gjithashtu e rëndësishme të kuptohet mënyra sesi funksionon konfiskimi pas dënimit. Rregullimi që i behet kesaj çështjeje nga sistemet e ndryshme mund të grupohet në 2 grupe:

- sistem i bazuar tek *aseti konkret* që është instrument i krimit ose produkt i krimit;
- sistemi i bazuar tek *vlera e aseteve* që janë përftuar si rezultat i krimit;

Sistemi i bazuar tek *aseti konkret* lejon konfiskimin e atyre aseteve që provohen se janë produkte ose instrumente të krimit. Sistemi i bazuar tek *vlera* lejon konfiskimin e cdo aseti (*edhe të atyre që nuk janë drejtpërdrejt instrument ose produkt i krimit, por që vlerësohen të barabartë në vlerë me to*).

Sistemi i bazuar tek *aseti synon* të identifikojë (*dhe eventualisht konfiskojë*) asete specifike që janë produkt pikërisht i atij krimi për të cilin dënohet subjekti. Ekziston edhe një version disi më i liberalizuar i këtij sistemi sipas të cilit nuk është e domosdoshme që aseti të jetë saktësisht produkt i krimit të dënuar, por mjafton që aseti të jetë produkt i një krimi (*pavarësisht se jo i atij krimi për të cilin është dënuar subjekti*). Siç mund të kuptohet nga këto shpjegime, sistemi në fjalë është i bazuar tek një ose disa asete konkrete. Prandaj nëqoftëse këto asete konkrete nuk mund të gjenden, i janë transferuar një personi të tretë, gjenden jashtë vendit, janë zhfletësuar apo janë përzier me asete të tjera të ligjshme, gjykata do të preferojë të vendosë si masë plotësuese një gjobë dhe jo konfiskim të aseteve.

Në të kundërtën sistemi i bazuar tek *vlera* lejon që të përcaktohet *vlera* e produkteve dhe mjeteve të krimit dhe konfiskimin e një vlere ekuivalente pavarësisht se asetet që konfiskohen nuk janë të lidhura drejtpërdrejt me krimin. Me fjalë të tjera gjykata llogarit “përfitim” që ka siguruar një kriminel i dënuar. Pasi llogarit përfitim, gjykata vlerëson aftësinë paguese të të denuarit. Në bazë të këtyre llogaritjeve gjykata nxjerr urdhërin e konfiskimit në një shumë të barabartë me përfitim e kriminelit ose me asetet e disponuara, cila të jetë më e ulët.

Në ditët tona, gjithnjë e me shume shtete po i adoptojnë të dyja qasjet e lartpërmendura duke lejuar qoftë konfiskimin e aseteve konkrete që provohen se janë produkt i krimit për të cilin është dënuar subjekti, qoftë nxjerrjen e një urdhëri konfiskimi bazuar në

përllogaritjen e përfitimit të kriminelit. Në disa vende metoda e asetit konkret konsiderohet si metoda kryesore por ajo plotësohet me metodën e vlerës në ato rastë kur aseti konkret nuk është i disponueshem për t'u konfiskuar për një sërë arsyesh si psh. i dënuari e ka transferuar asetin jashtë territorit dhe ai nuk gjendet as në juridiksione të tjera. Në disa vende të tjera statusi i të dy metodave është krejtësisht i barabartë.

Sa i takon bashkëpunimit ndërkombëtar për kthimin aseteve, prokurori duhet të mbajë parasysh se shtete të ndryshme do të zbatojnë kërkesat për ndihmë të ndersjelltë juridike në mënyra të ndryshme. Kështu në qoftë se kërkesa për të nxjerrë një urdhër konfiskimi (*apo për të zbatuar një urdhër konfiskimi të nxjerrë nga gjykata shqiptare*) i drejtohet një vendi që zbaton sistemin e bazuar tek aseti konkret, kërkesa për ndihmë të ndersjelltë duhet të specifikojë lidhjen midis krimit dhe asetit konkret. Po kështu edhe në rastin e kundërt. Në çdo rast, është esenciale që prokurorët të lidhen paraprakisht me homologët e tyre, të sigurohen paraprakisht se çfarë provash dhe materialesh duhen servitur dhe të kuptojnë mënyrën sesi funksionon sistemi i konfiskimit në vendin ku dërgohet kërkesa për ndihmë juridike të ndersjelltë.

4. Konfiskimi civil

Përpara se të iniciojë një procedurë për konfiskimin ndërkombëtar të aseteve të krimit një prokuror duhet të informohet nëse në vendin të cilit i dërgohet kërkesa për ndihmë ekziston mundësia e konfiskimit civil të aseteve.

Është e këshillueshme që ndihma ndërkombëtare për realizimin e një konfiskimi civil të konsiderohet nga prokurorët si opion i dytë. Në të vertetë kjo rrugë nuk ka pse të ndiqet kur i akuzuari ndodhet fizikisht në territorin e Shqipërisë dhe ka prova të mjaftueshme për të mbeshtetur akuzën penale. Sidoqoftë, në ato raste kur i dyshuari nuk gjendet ose mund të ketë vdekur ky opion mund dhe duhet të ndiqet. Në këto rrethana, konfiskimi civil mund të kërkohet ose të ekzekutohet me qëllim që të parandalohet gëzimi i produkteve të krimit nga vetë i dyshuari apo nga të afërmit dhe ortakët e tij jashtë vendit ose që të pengohet "trashëgimi" i ketyre produkteve nga pasardhësit e tij.

Sipas ligjit shqiptar, rruga e konfiskimit civil mund të ndiqet paralelisht dhe pavarësisht konfiskimit penal që vendoset pas dënimit personal. Në disa vende të tjera kjo nuk është e mundur dhe konfiskimi penal merr precedencë mbi atë civil. Është e rëndësishme që prokurori t'i ketë parasysh këto rrethana kur mendon të hartojë një kërkesë për ndihmë juridike të ndersjelltë që ka për objekt kërkimin e konfiskimit civil ose gjurmimin/identifikimin e aseteve me qëllim që të konfiskohen civilisht. Më konkretisht prokurori duhet të mbajë parasysh faktorët e mëposhtëm:

- cili mekanizëm funksionon më mirë në vendin në të cilin gjenden asetet që kërkohen të konfiskohen?
- sa e vështirë dhe/ose e kushtueshme është të sekuestrohen asetet në juridiksionin në të cilin ato gjenden përmes procesit penal dhe atij civil?
- A është e mundur të sigurohet një vendim konfiskimi i formës së prerë (pas dënimit penal)?
- A është e mundur të konfiskohen asetet e një personi juridik?
- Cilat janë rrugët ligjore përmes të cilave i dyshuari mund të kundërshtojë një urdhër konfiskimi që vjen nga Shqipëria?
- Cili do të jetë standarti i provës që do të përdoret në procesin gjyqësor në vendin ku bëhet kërkesa (*standarti penal përtej çdo kufiri të arsyeshëm apo standarti civil i balancës së mundësive*)?
- Çfarë rregullash zbatohen për pranueshmerinë e provave?
- Çfarë rregullash zbatohen për juridiksionin?
- Çfarë individësh/subjektesh mund të akuzohen?

Të gjitha këto duhet të studiohen paraprakisht nga prokurori.

5. Këshilla praktike

Verifikimi i parë që duhet të bëjë prokurori përpara se të nisë një procedurë për sekuestrimin ose konfiskimin ndërkombëtar të aseteve të krimit është që vepra penale bazë të konsiderohet e tillë në të dyja vendet. Po kështu në çdo procedurë të tillë është e nevojshme të justifikohet plotësisht nevoja e sekuestrimit/konfiskimit. Pa këtë informacion, gjykata në vendin pritës nuk do të mund të nxjerrë urdhërin për sekuestrimin e aseteve apo të lejoje zbatimin e vendimit të gjykatës shqiptare për konfiskimin e aseteve.

Autoriteti përgjegjës në vendin në të cilin dërgohet kërkesa do duhet të bëjë aplikimet përkatëse përpara gjykatës së vendit të tij për të siguruar sekuestrimin/konfiskimin dhe duhet ta informojë autoritetin përgjegjës të vendit kërkues për këto hapa.

Në shumicën e vendeve të botës është e mundur të kërkohet sekuestrimi i aseteve të krimit në emër dhe për llogari të një vendi tjetër në fazën hetimore të procedimit penal.

Informacione të domosdoshme për t'u përfshirë në një letër kërkesë për sekuestrimin e aseteve në një vend të huaj:

1. emri, adresa, kombësia, data dhe vendi i lindjes dhe vendndodhja aktuale e të dyshuarit/të pandehurit/të dënuarit;
2. detaje në lidhje me hetimin penal në vendin që bën kërkesën;

3. shpjegime në lidhje me ligjin që rregullon hetimin në vendin që bën kërkesën dhe provat që disponohen nga hetuesit në atë fazë të hetimit;
4. të dhëna në lidhje me asetet konkrete që kërkohen të sekuestrohen në vendin e huaj, personat që janë titullare të këtyre aseteve si dhe shpjegime për lidhjen midis personit të dyshuar dhe asetit (*kjo është veçanërisht e rëndësishme në qoftë se prona që kërkohet të regjistrohet është e regjistruar në emer të një personi të tretë, shoqëri tregtare ose person tjetër*);
5. të tregohet qartë nëse është dhënë asistencë e mëparshme nga vendi pritës (*psh. për gjurmimin dhe identifikimin e aseteve*) dhe nëse ka qenë kështu (*pra është dhënë asistence nga shteti pritës*) të jepen shpjegime të imëta për natyrën dhe rezultatet e asistencës së përfituar;
6. në rast se është vendi, duhet të jepen shpjegime në lidhje me ndonjë vendim gjyqësor në vendin kërkues kundër aseteve të të dyshuarit. Në qoftë se ka patur një vendim gjykate, vendimi i autentikuar sipas ligjit (*psh. i përkthyer, i noteruar, legalizuar dhe i sigluar nga autoriteti përgjegjës*) duhet t'i bashkëngjitet kërkesës;
7. një deklaratë e lëshuar nga Ministria e Drejtësisë që konfirmon sa më poshtë:
 - që një procedim penal ka filluar në vendin kërkues dhe që është në vijim;
 - që urdhëri që i kërkohet gjykatës të vendit të huaj ka për qëllim të rikuperojë asete që janë produkt ose instrument për kryerjen e atij krimi që po hetohet;
 - që çdo vendim i ardhshëm gjyqësor në lidhje me këtë çështje mund të zbatohet jashtë juridiksionit të vendit kërkues;
 - një kërkesë që vendi pritës t'i dërgojë vendit kërkues një kopje të autentikuar të vendimit të gjykatës.

Informacion shtesë që nevojitet të përfshihet në kërkesën për konfiskim

1. I gjithë informacioni që u shpjegua më lart dhe që serviret kur kërkohet sekuestrimi.
2. Në qoftë se kërkohet zbatimi i një vendimi gjyqësor duhet të përfshihet vendimi gjyqësor original ose një kopje e vërtetuar sipas rregullave; dhe
3. Një deklaratë e lëshuar nga autoriteti qëndror i shtetit kërkues (*Ministria e Drejtësisë*) që vërteton se:
 - vendimi për konfiskimin ka dalë në vijim të dënimit të personit në fjalë;
 - vendimi është i formës së prerë dhe se as vendimi për fajësinë dhe as ai për konfiskimin nuk mund të apelojnë;
 - se e gjithë ose një pjesë e shumës që duhet të kthehet sipas vendimit gjyqësor në vendin kërkues nuk është paguar në territorin e vendit kërkues ose që pronat e tjera që duhej të konfiskoheshin nuk kanë mundur të konfiskohen në vendin kërkues;
 - që vendimi për konfiskimin ka për qëllim të rikuperojë pronën, ose vlerën

ekuivalente të pronës të përfituar si rezultat i kryerjes së veprës penale, ose ka për qëllim të rikuperojë mjetet me të cilat është kryer krimi;

- vendimi mund të zbaohet jashtë juridiksionit të vendit kerkues.

Shenim: Gjykata e vendit të cilit i dërgohet kërkesa duhet të bindet që lëshimi nga ana e saj i një urdhëri sekuestrimi ose konfiskimi, ose lejimi i zbatimit të një vendimi sekuestrimi apo konfiskimi të lëshuar nga gjykata në vendin kerkues nuk bie ndesh me ndonjërin nga të drejtat e njeriut sipas Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut (*apo sipas ndonjë instrumenti tjetër rajonal në qoftë se kërkesa i drejtohet një vendi jashtë Europës*).

6. Vështirësitë dhe pengesat që hasen tipikisht në procesin e bashkëpunimit ndërkombëtar për sekuestrimin/konfiskimin e aseteve të krimit

Puna e prokurorit për të bërë të mundur sekuestrimin/konfiskimin ndërkombëtar të aseteve të krimit karakterizohet nga vështirësitë e mëposhtme:

- Anonimiteti i transaksioneve që shpesh pengon zbulimin e fondeve dhe aseteve dhe parandalimin e transferimeve të mëtejshme
- Mungesa e asistencës teknike (*psh. asistenca e një eksperti kontabël*) dhe e burimeve financiare e njerëzore;
- Paqartësi në lidhje me fazën në të cilën mund të kërkohe bashkëpunimi (*a mjafton që të ketë filluar hetimi apo duhet të jetë dënuar personi*) për kthimin e aseteve të krimit;
- Problemet ligjore si psh. fakti që një sjellje e caktuar nuk konsiderohet vepër penale në të dyja vendet, imunitetet, të drejtat e pronësisë të të tretëve etj.
- Çështje që lidhen me pranueshmerinë e provave, lloji dhe fuqia provuese e provave të nevojshme, ndryshimet ligjore në lidhje me sekuestrimet/konfiskimet *in rem*, koha e gjatë që nevojitet për përmylljen e procesit;
- Mungesa e ekspertizës, burimeve, trainimeve të specializuara;
- Mungesa e vullnetit shtetëror për të vepruar ose bashkëpunuar me efektivitet;
- Fakti që autorët e krimit të organizuar dhe atij financiar janë të lidhur mirë dhe mund t'i lejojnë vetes mbrojtje juridike të nivelit me të lartë duke qenë të aftë të kërkojnë strehë në disa juridiksione dhe t'i lëvizin dhe investojnë asetet e tyre në menyra diskrete duke vështirësuar kështu zbulueshmerinë.

Aneks 1. Kërkesë tip për Sekuestrim të Aseteve

Në vëmendje të:

Autoriteti kompetent gjyqësor në Republikën/Mbretërinë e

Data

LETËR KËRKESË:

Të Nderuar Zotërinj

Prokuroria e Shqipërisë i paraqet komplimentat autoriteteve kompetente gjyqësore të Republikës/ Mbretërisë sëdhe ka nderin të kërkojë asistencen e tyre, në përputhje me *(lista e burimeve të mundshme të së drejtës ndërkombëtare që mund të shërbejnë si bazë për të kërkuar bashkëpunimin ndërkombëtar për sekuestrimin/funksionimin e asetëve dhe instrumenteve të krimit në hetimin e veprave penale të rënda dhe financiare, në varësi të çështjes)*:

1. Konventën Europiane për Ndihmën e Ndërsjellë në Çështje Penale,
2. Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkufitar,
3. Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit,
4. Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Trafikut të Paligjshëm të Narkotikëve dhe Substancave Psikotropike dhe
5. Nenet 11 dhe 12 të Konventës së Këshillit të Europës për Pastrimin, Depistimin, Sekuestrimin dhe Konfiskimin e të Ardhurave nga Krimi

në lidhje me një procedim penal të nisur nga Prokuroria e Rrethit Kundër

Në bazë të Kushtetutës dhe Ligjit nr., datë..... "Kodi i Procedures Penale", prokuroria ushtron ndjekjen penale në Republikën e Shqipërisë. Në bazë të rregullave të juridiksionit *(trego nenet përkatëse të Kodit të Procedures Penale)* prokuroria e rrethit gjyqësor ka juridiksion për të ushtruar ndjekjen penale në rastin për të cilin kërkohet ndihmë. Unë *(emri i prokurorit)* jam caktuar të ndjek këtë çështje në bazë të urdhërit Gjithashtu unë kam cilësinë a autoritetit gjyqësor lokal sipas nenit 24 të Konventës Europiane për Ndihmën e Ndërsjellë në Çështjet Penale. Në bazë të nenit 5 të ligjit nr. 10193, datë 3 dhjetor 2009 "Për Marrdhëniet Juridiksionale me Autoritetet e Huaja në Çështje Penale" prokuroria ka të drejtë të nxjerrë letër kërkesa për të kërkuar

ndihmë të ndersjelltë nga autoritetet e huaja gjyqësore. Për sa më sipër jam i autorizuar të nxjerr këtë letër kërkesë si më poshtë.

Një procedim penal ka filluar në Republikën e Shqipërisë kundër:

Emri

Adresa:

Kombësia:

Data dhe vendi i lindjes:

Kjo kërkesë ka 2 qëllime:

1. të sigurojë prova të cilat të merren parasysh nga gjykata shqiptare në nxjerrjen e një vendimi për konfiskimin e aseteve të z.....;

2. të bëjë të mundur sekuestrimin në Republikën/Mbretërinë enë mënyrë që ato të jenë në dispozicion për çdo vendim konfiskimi që mund të nxjerrë gjykata shqiptare.

- Shpjegime për stadin në të cilin ndodhet çështja penale.
- Shpjegime në lidhje me kuadrin ligjor që zbatohet në rastin konkret dhe dënimet e parashikuara nga ligji.
- Shpjegime në lidhje me kushtet dhe mënyrën sesi vepron gjykata për të llogaritur dhe vendosur masën e sekuestros dhe të konfiskimit.
- Bashkëngjit si aneks nenet relevante të ligjit për veprën penale bazë;
- Bashkëngjit si aneks nenet që rregullojnë konfiskimin;
- Bashkëngjit si aneks cdo vendim për sekuestron që mund të ketë nxjerrë gjykata shqiptare;
- Përmbledhja e fakteve të ngjarjes.

Shembuj të shërbimeve që mund të kërkohen nga vendi pritës:

1. Një vizitë në bankëndhe marrja e një deklarami nga menaxheri i bankës në lidhje me llogarinë bankare nr....., në emër të Deklarata kërkohet me qëllim që të sigurohen informacionet e mëposhtme:

- (1) Kur është hapur llogaria dhe nga kush (përfshi të dhëna për firmat e autorizuar në këtë moment);
- (2) shumat dhe datat e depozitave dhe tërheqjeve nga llogaria;
- (3) Informacione në lidhje me transfertat bankare, çeqet dhe shënimet të mundshme të menaxherit të bankës;
- (4) Detaje në lidhje me çdo dokument tjetër që ka banka në emër tëtë tilla si letra me vlerë, teste etj.;
- (5) Kontrolli i cdo kasaforte që mbahet nga banka për llogari të z.....;

- (6) Detaje të korrespondencës që lidhet me llogarinë dhe;
- (7) Kopje të dokumentave relevantë të tilla si:-
 - (a) Bank statements (vëtetim bankar i gjendjes së llogarisë);
 - (b) Dokumenta të tjera që lidhen me llogarinë

Këto informacione kërkohen në mënyrë që të ndihmohet gjykata shqiptare në llogaritjen e përfitimit dhe masën e konfiskimit.

2. Në qoftë se nga kontrolli i mësipërm rezultojnë të dhëna për llogari të tjera të përbashkëta në Republikën/Mbretërinë, atëhere kërkohet asistencë për hetime në lidhje me secilin bashkëfirmëtar si më poshtë:

- (1) të merret dëshmia e bashkëfirmëtarit dhe
- (2) të merret deklaratë e shkruar nga bashkëfirmëtari lidhur me përdorimin e llogarisë së përbashkët

3. Të vizitohet zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme në Republikën/Mbretërinë e dhe të merret një deklaratë e shkruar nga kryeregjistruesi në lidhje me pronat e mëposhtme:

- (1)
- (2)
- (3)
- (4)

Deklarata me shkrim e kryeregjistruesit kërkohet në mënyrë që të sqarohen çështjet e mëposhtme lidhur me këto prona:

- (1) data e regjistrimit të pronës dhe emri i subjektit në të cilin është regjistruar prona;
- (2) shuma për të cilën është blerë prona;
- (3) interesi i z. në pronën në fjalë; dhe
- (4) kopje të dokumentave relevantë.

5. Në qoftë se nga hetimi i regjistrave të pasurive të paluajtshme në Republikën/Mbretërinë e rezultojnë detaje në lidhje me bashkëpronësi të z. me persona të tjerë, atëhere kërkohet ndihmë në lidhje me secilin bashkëpronar si më poshtë:

- (1) të merret dëshmia me shkrim e bashkëpronarit në mënyrë që të tregohet:
 - (a) arsyeja e zotërimit të përbashkët të pronës;
 - (b) lidhja e tij/saj me z.....

6. Në qoftë se hetimet e mësipërme në regjistrin e pasurive të paluajtshme tregojnë se ndonjë nga pronat objekt i hetimit është në pronësi to plotë ose të pjesshme të palëve të treta, atëhere kërkohet ndihmë në lidhje me secilën nga palët e treta si me poshtë:

(1) të merret deshmia e pales se tretë dhe një deklaratë e saj me shkrim në lidhje me:

(a) lidhjet e tij/saj me z.;

(b) rrethanat në të cilat z. është apo është i lidhur me pronën; dhe

(c) hollësi në lidhje me çdo kontratë qeraje mbi ato prona të lidhura me z. ose secilën nga kompanitë e mëposhtme:

(i)

(ii)

(iii)

7. Të verifikohet adresa e shoqërise tregtare Pastaj të merret deklaratë me shkrim nga menaxheri në lidhje me policën e sigurimit nr. Për qëllimet e mëposhtme:

(1) kur është hapur polica dhe nga kush përfshi informacion për përfituesit aktualë;

(2) kushtet e policës së sigurimit;

(3) të gjitha shumat dhe datat në të cilat janë derdhur depozitat në policë;

(4) detajet e korrespondencës lidhur me këtë policë; dhe

(5) kopje të dokumentave relevantë

Këto informacionë kërkohen në mënyrë që të ndihmohet gjykata shqiptare në llogaritjen e përfitimit dhe masën e konfiskimit.

8. Të vizitohet regjistri tregtar (i shoqërive tregtare) në Republikën/Mbretërinë e, dhe të merret deklarata me shkrim e kryeregjistruesit të kompanive në lidhje me secilën nga kompanitë e mëposhtme:

(1) _____

(2) _____

(3) _____

Deklarata me shkrim nga kryeregjistruesi i kompanive kërkohet në lidhje me çështjet e mëposhtme për çdo kompani:

- (1) kur është krijuar kompania dhe nga kush;
- (2) cilët janë aksioneret e kompanisë;
- (3) cilet janë drejtuesit/drejtorët e kompanisë;
- (4) cili është qëllimi për të cilin është krijuar kompania;
- (5) llogaritë bankare të kompanisë;
- (6) hollësi në lidhje me korrespondencën me këto kompani;
- (7) kopje të dokumentave relevantë përfshirë:

- (a) aktin e themelimit;
- (b) statutin;
- (c) deklaratat e depozituara nga kompania, dhe
- (d) çdo dokument tjetër i kompanisë

Këto informacione kërkohen në mënyrë që të ndihmohet gjykata shqiptare në llogaritjen e përfitimit dhe masën e konfiskimit.

Në qoftë se kërkimi në bazën e të dhënave për shoqëritë tregtare tregon detaje në lidhje me drejtorët apo aksioneret e tjerë që banojnë në Republikën/Mbretërinë, atëhere kërkohet që hetimi të shtrihet edhe mbi secilin aksioner ose drejtor të kompanisë duke marrë dëshminë me shkrim të drejtorit/aksionerit në lidhje me punën e shoqërisë dhe lidhjet e tyre me z.

Në qoftë se kërkimi në bazën e të dhënave të shoqërive tregtare në Republikën/Mbretërinë, nxjerr të dhëna për ekzistencën e llogarive të tjera bankare në emër të z. ose në bashkëpronësi të z., atëhere kërkohet edhe një herë ndihma e specifikuar më lart në lidhje me këto llogari.

9 Të vizitohet autoriteti i licensimit të automjeteve në Republikën/Mbretërinë dhe të merret deklaratë me shkrim nga oficeri i autorizuar në lidhje me:

- (1) pronësinë mbi automjetin me numer shasie
- (2) etj
- (3) etj.

10. Të merret dëshmia me shkrim e çdo pale të tretë në lidhje me sa më poshtë:

- (1) Rrethanat në të cilat është blerë prej tij/saj automjeti me numër shasie;
- (2)
- (3) etj.

11. Të vizitohet zyra e taksave në Republikën/Mbretërinë dhe të merret deklarimi me shkrim i zyrtarëve të autorizuar në lidhje me deklaratat tatimore të

kompanive të përmendura me sipër. Deklarimi me shkrim synon të sigurojë informacion në lidhje me kompanitë për periudhën kohore nga, deri në

- (1) të ardhurat dhe shpenzimet e deklaruar të secilës prej kompanive;
- (2) fitimet e deklaruar të secilës prej kompanive;
- (3) të ardhurat e deklaruar të drejtorëve; dhe
- (4) kopje të dokumentave relevantë

Këto informacione kërkohen në mënyrë që të ndihmohet gjykata shqiptare në llogaritjen e përfitimit dhe masën e konfiskimit.

Prova Shkresore

Shpjegime në lidhje me kërkesat e ligjit shqiptar për pranueshmerinë e provave. Nenet përkatëse të bashkëngjiten si aneks.

Shpjegime për ndihmën konkrete që kërkohet.

1. Kërkohet që të gjitha të hollat, pronat dhe llogaritë bankare në pronësi të z. të sekuestrohen. Në këtë moment prokurori i konfirmon palës tjetër të cilës i kërkohet të veprojë se në qoftë se autoritetet e Republikës/Mbretërisë, do të kërkonin kryerjen e një veprimi të tillë nga autoritetet shqiptare, kjo ndihmë do t'ju jepej me kushtin e vetëm që një procedim penal të ketë filluar në vendin që bën kërkesën.

2. I konfirmon autoriteteve në Republikën/Mbretërinë se një kërkesë për zbatimin e një urdhëri konfiskimi do të dërgohet nga qeveria e Republikës së Shqipërisë sa më shpejt pas daljes së vendimit për konfiskimin. Duhet konfirmuar gjithashtu se procedimi është ende në vijim.

3. Në qoftë se hetimet e kërkuara nxjerrin në pah vendndodhjen ose identitetin e ndonjë prone në emër të z., kërkohet që kjo pronë të kontrollohet dhe që çdo element që mund të ketë rëndësi për hetimin të ruhet.

4. Që të sigurohen të gjitha vendimet e nevojshme gjyqësore sipas ligjit të Republikës/Mbretërisë për kryerjen e hetimeve të kërkuara më lart.

5. Që të bëhen edhe hetime të tjera, të intervistohen persona të tjere apo të ruhen dokumenta të tjera që do të gjykohen të nevojshme nga autoritetet e vendit pritës në kryerje e sipër të hetimit për identifikimin e pronave të tjera në pronësi të z.

6. Që të jepet një indikacion nëse ndonjë nga dëshmitarët do të ishte i gatshëm të udhëtonte në drejtim të Shqipërisë për të dëshmuar personalisht.

7. Që prokurori x, oficeri i policisë gjyqësore y, eksperti z, të udhetojnë në drejtim të Republikës/Mbretërisë dhe të jenë të pranishëm në kryerjen e verifikimeve të përmendura më sipër dhe që të lejohet prokurori x që të marrë kopje të deklaratave dhe dokumentave që janë relevantë për hetimin.

8. Që kopje të nënshkruara dhe të vërtetuara të të gjitha deklaratave, të të gjitha dokumentave apo provave të siguruara gjatë kryerjes së kontrolleve t'i dorëzohen prokurorit x dhe t'i jepet atij leja që t'i transportojë ato në Shqipëri në mënyrë që të përdoren në:

- (a) çdo seance gjyqësore që ka për qëllim të nxjerrë urdhërin për konfiskim kundër z.;
- (b) çdo procedim ndihmës ndaj procedimit penal baze;

Ju falenderoj paraprakisht për bashkëpunimin tuaj në lidhje me këtë çështje.

Me respekt

Prokurori